

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË “WEB PLATFORM INNOVATION” SH.P.K.**

Në Tiranë, sot më datën 10.12.2024, Unë ortaku:

**Marius Memajdini**, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 08.07.1993, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me kartën e identitetit Nr. 039607167 dhe numer personal J30708068S ,konform Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, hartoj këtë Akt Themelimi:

1. Me vullnetin tim të lirë themeloj shoqërinë me emërtimin “Web Platform Innovation” Sh.p.k. me seli në Tiranë, në adresën: Rruga “Kristo Luarasi”, Njesia B-5, Kati 3, Seksioni B, kuota +11.24, Tirane.
2. Themeluesi i kësaj shoqërie është Z. Marius Memajdini.
3. Selia dhe qendra e kësaj shoqërie është në adresën Rruga “Kristo Luarasi”, Njesia B-5, Kati 3, Seksioni B, kuota +11.24, Tirane.
4. Vula e shoqërisë përmban mbishkrimin “Web Platform Innovation” Sh.p.k dhe Niptin e shoqërisë.
5. Shoqëria krijohet me mjetet financiare pronë e ortakut Marius Memajdini, në masën 100%. Kapitali themelor i shoqërisë është caktuar në shumën 800.000 lekë dhe përbëhet nga 1 kuotë me vlerë nominale 800.000 lekë, ku ortaku Marius Memajdini zotëron 100% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë.
6. Kjo shoqëri ka statusin e personit juridik shqiptar dhe i nënshtrohet legjislacionit përkatës shqiptar.
7. Afati i veprimtarisë së saj do të jetë i papërcaktuar. Ky afat mund të zgjatet dhe mund të shkurtohet në rastet kur shoqëria do të shpërbëhet sipas përcaktimeve që pasqyrohen në statut.
8. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:  
“Veprimtari në fushën e marketingut digital dhe teknologjise të informacionit, web design, krijim dhe menaxhim i faqeve të internetit, programim i aplikacioneve të ndryshme kompjuterike dhe elektronike.”
9. Organ vendimarrës me i lartë në shoqëri është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve që thirret në seancë të zakonshme të paktën një herë në vit dhe drejtohet nga administratori i shoqërisë. Asambleja merr vendime të zakonshme dhe të jashtëzakonshme sipas dispozitave ligjore të përcaktuara në statut.
10. Shoqëria administrohet nga administratori i cili është ortaku i shoqërisë ose një personi tjetër. Kompetencat e administratorit përcaktohen në statut. Me themelimin e këtij akti, administrator i shoqërisë për një afat 5 vjeçar caktohet Marius Memajdini.



11. Në këtë shoqëri mund të aderojnë ortakë të tjerë të rinj në kushtet që do të përcaktohen në akt marrëveshjen e bërë në rastin e pranimit të tyre.
12. Po ashtu ortakët kanë të drejtën të ndryshojnë apo shtojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë, sipas interesave të veta ekonomike dhe financiare.
13. Shoqëria ka të drejtë të punësojë specialistë të fushës që i përket objektit të veprimtarisë si dhe punonjës të tjerë me kontratë pune sipas përcaktimeve në Kodin e Punës dhe përgjithësisht me legjislacionin shqiptar në fuqi.
14. Do të konsiderohen veprimtari të Shoqërisë vetëm ato veprime juridiko-civile që do të kryhen nga organet e saj konform disponimeve në Statutin e Shoqërisë dhe në mbështetje të legjislacionit në fuqi.
15. Si rregull veprimet ekonomike të Shoqërisë mbyllen më 31 Dhjetor të çdo viti, përjashtim nga ky rregull do të bëhet kur kërkon organi kompetent ligjor.
16. Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakut të vetëm, administratorit dhe personave të tjerë të punësuar në Shoqëri, në rast se nuk zgjidhen me pajtim, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.
17. Fitimi i nxjerrë nga aktiviteti i ligjshëm i kësaj shoqërie tregtare është në favor të ortakëve të shoqërisë në masën 100% për ortakun.
18. Ndërkohë ortakun mbart mbi vete rrezikun e humbjes deri në masën 100% të kapitalit themeltar dhe atij rezervë.
19. Për detyrimet që mund t'ju ketë personave të tjerë juridikë apo fizikë, shoqëria përgjigjet me mjetet e veta financiare dhe materiale.
20. Për funksionimin normal të shoqërisë do të hartohet statuti i shoqërisë ku do të parashikohen hollësitë e mirëfunksionimit dhe administrimit të saj.
21. Veprimtaria e saj private ushtrohet brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
22. Kjo shoqëri mund të mbyllë aktivitetin e vet në rastet e parashikuara në legjislacionin shqiptar dhe në statutin e saj.
23. Shoqëria do të marrë personalitet juridik me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Një kopje e aktit të themelimit së bashku me statutin e shoqërisë, depozitohen dhe ruhen në QKB (Qendrën Kombëtare e Biznesit).

**ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË  
“WEB PLATFORM INNOVATION” Sh.p.k**

**Z. Marius Memajdini**

Marius Memajdini

